

Te dhena per veprimtarinë ekonomike të Universitetit të Arteve për vitin 2014


Buxheti i shpenzimeve për tu realizuar nga Universiteti i Arteve, për vitin 2014, me burim financimi buxhetin e shtetit dhe të ardhurat e vetë institucionit, ishte si ne tabelen e mëposhtme:

Art.	Emertimi	Kapitulli Nr.1	Kapitulli Nr.6	Kapitulli Nr.8	TOTALI
600	Paga		41,803,329	173,435,163	215,238,492
601	Sigurime shoqer. dhe shendet.		2,650,000	29,522,157	32,172,157
602	Mallra dhe sherbime te tjera		22,018,000	-	22,018,000
605	Transferimet korrente jashte		106,000	-	106,000
606	Bursa per studentet	3,450,000		-	3,450,000
606	Transferta per buxhetet e individ.	10,000		1,246,680	1,256,680
	TOTALI	3,460,000	66,577,329	204,204,000	274,241,329

Shënime:

1. Kapitulli 1 – janë fonde të akorduara nga buxheti i shtetit për bursa për studentët.
2. Kapitulli 6 – janë të ardhurat e parashikuara për tu realizuar gjatë vitit 2014 me vlerë 62.639.764 lek, si dhe të ardhurat e trashëguara dhe të pashfrytezuara nga viti 2013, me vlerë 3.937.565 lek.
3. Kapitulli 8 – janë fonde të dhena në formë granti nga buxheti i shtetit (Ministria e Arsimit dhe Sporteve) për paga, shpenzime operative, etj.


Pesha specifike që zë cdo kapitull i buxhetit, në buxhetin total të viti 2014, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



Realizimi i buxhetit të shpenzimeve të Universitetit të Arteve, për vitin 2014, është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Art.	Emertimi	Plani(P) Viti 2014	Fakti (F) Viti 2014	Diferenca (P-F)	% e realizimit
600	Paga	215,238,492	212,309,318	2,929,174	99%
601	Sigurime shoqër. dhe shëndet.	32,172,157	32,140,431	31,726	100%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	22,018,000	21,695,632	322,368	99%
605	Transferimet korrente jashtë	106,000	105,261	739	99%
606	Bursa per studentët	3,450,000	3,194,221	255,779	93%
606	Transferta për buxhetet e individ.	1,256,680	1,256,680	-	100%
TOTALI		274,241,329	270,701,543	3,539,786	99%

Pesha specifike e cdo zëri të shpenzimeve, në shpenzimet totale të realizuara gjatë vitit 2014, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



PAGA (600)
SIGURIMET SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE (601)

Art.	Emertimi	Plani(P) Viti 2014	Fakti(F) Viti 2014	Diferenca P-F	% e realizimit
600	Paga	215,238,492	212,309,318	2,929,174	99%
601	Sigurime shoqër. dhe shëndetësore	32,172,157	32,140,431	31,726	100%
	TOTALI	247,410,649	244,449,749	2,960,900	99%

Zëri "Paga" – për vitin 2014, granti i akorduar Universitetit të Arteve, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, mbulonte vetëm pagat dhe sigurimet shëndetësore dhe shoqërore të personelit të brendshëm akademik dhe administrativ, për periudhën Janar-Tetor 2014.

Në këto kushte, për periudhën Nëntor-Dhjetor 2014, pagat dhe sigurimet shëndetësore dhe shoqërore të personelit të brendshëm akademik dhe administrativ, u mbuluan me të ardhurat e krijuara nga UART, të cilat ishin destinuar për pagesën e personelit akademik të ftuar dhe orët mbinormë të personelit akademik të brendshëm.

Theksojme se, shpenzimet e personelit akademik të ftuar dhe orët mbinormë të personelit akademik të brendshëm, për vitin akademik 2013-2014, që ishin parashikuar të shlyheshin brënda vitit 2014, por nuk u shlyen, janë **24.482.720 lek** (*shpenzime personel i ftuar 17.886.783 lek, shpenzime orë mbinormë personel i brendshëm 6.595.937 lek*).

Referuar sa më sipër, pavaresisht se për vitin 2014 ka një mosrealizim të buxhetit për paga prej **2.929.174 lek**, shpenzimet reale të pagave për vitin 2014 (*duke përfshirë edhe pagesën e personelit akademik të ftuar dhe orët mbinormë të personelit akademik të brendshëm*) e kalojnë buxhetin për paga me vlerë **21.553.546 lek** (*24.482.720 lek - 2,929,174 lek*). Kjo vlerë është një detyrim i vitit 2014, i cili do të trashëgohet për vitin 2015.

MALLRA DHE SHERBIME (602)


Nr. Llog.	Emertimi	Plani (P) Viti 2014	Fakt (F) Viti 2014	Diferenca P-F	% e realizimit
6020	Mallra dhe shërbime të tjera	818,200	771,120	47,080	94%
6021	Materiale dhe shërbime speciale	265,500	234,220	31,280	88%
6022	Shërbime nga të tretë(energji,uje,ngrohje)	13,231,153	13,123,783	107,370	99%
6023	Shpenzime transporti	104,628	104,628	-	100%
6024	Shpenzime udhëtimi	463,100	463,100	-	100%
6025	Shpen. per mirëmbajtje të zakonshme	502,000	462,000	40,000	92%
6029	Shpenzime të tjera operative	6,633,419	6,536,781	96,638	99%
	TOTALI	22,018,000	21,695,632	322,368	99%

- Zëri "Mallra dhe shërbime të tjera", "Materiale dhe shërbime speciale", "Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme" dhe "Shpenzime të tjera operative" – mosrealizimet

kanë ardhur si rrjedhojë e raportit kërkesë-oferte, mbasi përzgjedhja e fituesve për realizimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve, është mbështetur në procedurat e prokurimit publik.

- Zëri “Shërbime nga të tretët” - mosrealizimi ka ardhur si pasojë se është konsumuar energji elektrike, ujë dhe shpenzime telefonike më pak nga sa ishte parashikuar. Parashikimi ishte realizuar bazuar ne shpenzimet e realizuara gjatë vitit 2013.

Pesha specifike qe zë cdo shpenzim, në shpenzimet totale të realizuara për mallra dhe shërbime, gjatë vitit 2014, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:




TE ARDHURAT

Të ardhurat e realizuara nga Universiteti i Arteve, gjatë vitit 2014, janë si në vijim:

Nr.	Burimi i krijimit i te ardhurave	Parashikimi Viti 2014	Realizimi Viti 2014	Diferanca P-R	% e realizimit
1	Tarifë Shkollimi	54,411,604	75,388,590	20,976,986	139%
2	Shërbim salle	3,000,000	2,515,000	(485,000)	84%
3	Konkurse pranimi	2,310,000	2,261,500	(48,500)	98%
4	Qera ambjenti	2,132,560	2,040,545	(92,015)	96%
5	Librezë, diplomë	250,000	374,000	124,000	150%
6	Tarifë regjistrimi	385,600	751,600	366,000	195%
7	Shtypshkrime, vërtetime etj	150,000	148,000	(2,000)	99%
TOTALI		62,639,764	83,479,235	20,839,471	133%

- Zëri “Tarifa shkollimi” - si dhe vihet re në tabelën e mësipërme, realizimi i këtij zëri tejkalon planin, por që në terma ekonomik nuk është real. Tejkalmi ka ardhur si pasojë se, tarifat e shkollimit të masterit për vitin akademik 2014-2015, të cilat janë parashikuar si të ardhura në buxhetin e vitit 2015 dhe për t’u arketuar brenda Mars 2015, bazuar në VKM-te e nxjerra në Tetor 2014, u arketuan në Dhjetor 2014.
- Zeri “Shërbim salle” - mosrealizimi në këtë zëri ka ardhur si pasojë se, interesi për marrjen me qera të sallave të UART nga të tretet, ka qenë më i vogël nga ai i pritshmi.
- Zeri “Konkurse pranimi” - mosrealizimi në këtë zëri ka ardhur si pasojë se, numri i konkurrentëve për pranim në Universitetin e Arteve, ka qenë më i vogël nga ai i parashikuari.
- Zeri “Qera ambjente” - mosrealizimi në këtë zëri ka ardhur si pasojë se subjekti “Corner” shpk, i cili ka marrë me qera ambjent në UART, ka paguar paradhanie në Dhjetor 2013, qerane për periudhën Janar-Maj 2014 me vlerë 124.750 lek.
- Zëri “Tarifa regjistrimi” –në këtë zëri është me një realizim që tejkalon planin mbasi për vitin 2014, me VKM të nxjerrë në Tetor 2014, u shtua tarifa për rregjistrim në konkurset e pranimit të studenteve në ciklin II (Master) me vlerë 3.000 lek. Parashikimi për këtë zëri ishte bazuar në VKM e vitit 2013, që nuk parashikonte pagesë për rregjistrim në konkurse për ciklin e dytë.

Pesha specifike që zë cdo burim, në të ardhurat totale të realizuara gjatë vitit 2014, është paraqitur në grafikun e mëposhtëm:



TE TJERA

Ne tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e realizuara për vitin 2014, krahasuar me vitin 2013.

Art.	Emertimi	Shpenzime Viti 2013 (Lek)	Shpenzime Viti 2014 (Lek)	Diferenca 2014-2013 (Lek)	% e rritjes
231	Investime	1,731,414	-	(1,731,414)	-100.00%
600	Paga	233,974,227	236,792,038	2,817,811	1.20%
601	Sigurime shoqër. dhe shëndet.	30,572,285	32,140,431	1,568,146	5.13%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	21,738,104	21,695,632	(42,472)	-0.20%
605	Transferimet korrente jashtë	120,000	105,261	(14,739)	-12.28%
606	Bursa për studentët	3,686,172	3,194,221	(491,951)	-13.35%
606	Transferta për buxhetet e individ.	1,040,000	1,256,680	216,680	20.83%
TOTALI		292,862,202	295,184,263	2,322,061	0.79%